

Ligji Nr. 25, datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

Versioni i konsoliduar me ndryshimet e propozuara nga Projektligji Nr. _____/2026 · Dokument pune – AIProfit Consult



Tekst i shtuar / i ri



Tekst i fshirë



Nen i ri (i shtuar plotësisht)

Teksti pa ngjyrë = ligji aktual i pandryshuar

23

NENE PROJEKTI

8

NENE TË REJA

15

NENE TË NDRYSHUARA

2026

VITI I PROPOZIMIT

NDRYSHIMET SIPAS NENIT

Neni 1 – Objekti (shtesë)

Neni 3 – Përkufizime (pika 19–26 të reja)

Neni 4 – Kategoritë e njësive (ndryshim pika 4 e 6)

Neni 5 – Standardet kontabël (ndryshim pika 2)

Neni 8 – Ruajtja e dokumenteve (10 vjet → 5 vjet)

Neni 9 – Periudha raportuese (fshirje fjale)

Neni 12 – Pasqyrat e konsoliduara (shtesë e ndryshim)

Neni 12/1 – I RI: Kushtet e konsolidimit

Neni 15 – Inventari i aktiveve (pika 1 e ndryshuar)

Neni 16 – Shënime shpjeguese (shtesë shkronjat b, c dhe pika 5)

Neni 17 – Raporti i ecurisë (ndryshim subjekti e shtesë)

Neni 18 – Raporti jofinanciar (heqja e kushti NIP)

Neni 18/1 – I RI: Raportimi i qëndrueshmërisë

Neni 18/2 – I RI: Zinxhiri i vlerës

Neni 19 – Drejtimi i brendshëm (shtesë)

Neni 20/1–20/7 – TË RINJ: Raportimi i konsoliduar i qëndrueshmërisë

Neni 21 – Pagesat institucionale (ndryshime)

Neni 22 – Depozitimi (pika 1 e reformuluar, shtesë 4–6)

Neni 23 – Përgjegjësitë (ndryshime terminologjike e shtesë)

Kreu III/1 – I RI: Raporti i tatimit mbi të ardhurat (nenet 23/1–23/4)

Neni 24 – KKK: detyrat (ndryshim autoritetin)

Neni 25 – KKK: mandati (shtesë "lirohen")

Neni 31 – Dispozita kalimtare (pikat 4 e 5 të reja)

KREU I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 • Objekti *Ligji aktual + shtesë*

Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme për hartimin dhe përbërësit e pasqyrave financiare, përcaktimin e standardeve kontabël të zbatueshme, si dhe mbajtjen e kontabilitetit.

↑ **FJALI E RE E SHTUAR PAS FJALISË SË PARË**

"Gjithashtu, ky ligj përcakton kërkesat për raportimin e qëndrueshmërisë nga njësitë ekonomike të përcaktuara në këtë ligj."

Neni 3 • Përkufizime *Shtohen pika 19–26*

Pikat 1–18 mbeten të pandryshuara. Pas pikës 18 shtohen këto përkufizime të reja:

↑ **PIKA 19–26 TË REJA**

19. "Palë e lidhur" - ka të njëjtin kuptim si në standardet e raportimit financiar që zbaton njësia ekonomike.

20. "Njësi ekonomike të lidhura" - janë dy ose më shumë njësi brenda një grupi.

21. "Njësi ekonomike investimi" - njësi objekti i vetëm i të cilave është investimi i fondeve të tyre në tituj, pasuri të paluajtshme ose aktive të tjera për shpërndarjen e rreziqeve dhe dhënien e përfitimeve aksionarëve; si dhe njësi pjesëmarrëse në njësi investimi me kapital fiks.

22. "Standardet e Raportimit të Qëndrueshmërisë" (SRQ) - standardet e hartuara nga EFRAG, të përkthyer në shqip nën përgjegjësinë e KKK-së, të shpallura me urdhër të ministrit.

23. "Standardet Vullnetare të Raportimit të Qëndrueshmërisë" (SVRQ) - standardet e EFRAG-ut për përdorim vullnetar, të shpallura me urdhër të ministrit.

24. "Çështje të qëndrueshmërisë" - faktorë mjedisorë, socialë, të të drejtave të njeriut dhe faktorë qeverisje, duke përfshirë çështjet kundër korrupsionit ose ryshfetit.

25. "Raportim i qëndrueshmërisë" - informacion mbi çështjet e qëndrueshmërisë sipas neneve 18/1, 20/1, 20/2 dhe 20/3.

26. "Të ardhura" (për Kreun III/1) - kuptim i njëjtë me "të ardhura" sipas kuadrit të raportimit financiar mbi bazën e të cilit përgatiten pasqyrat financiare.

Pika 4 – Rritja e kufijve çdo tre vjet

Teksti aktual parashikonte konvergjencën me BE deri në vitin 2028. Ky togfjalësh fshihet:

TEKSTI AKTUAL (PIKA 4, FRAGMENT)

...rriten çdo tre vjet, në mënyrë të përpjesëtuar, sipas aneksit 1, pjesë integrale e këtij ligji, me qëllim përafrimin e tyre të plotë në vitin 2028 me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

PAS NDRYSHIMIT

...rriten çdo tre vjet, në mënyrë të përpjesëtuar, sipas aneksit 1, pjesë integrale e këtij ligji, me qëllim përafrimin e tyre të plotë me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

Pika 6 – Reformulim i plotë

TEKSTI AKTUAL

Pas përafrimit të plotë të kufijve, sipas pikës 3, të këtij neni, me kufijtë e parashikuar në legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian, për të rregulluar efektet e inflacionit, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit duhet, të paktën një herë në 5 vjet, të rishikojë dhe, kur është e nevojshme, të propozojë ndryshimet e kritereve të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, bazuar në matjen e inflacionit, të cilat miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.

TEKSTI I RI (PAS NDRYSHIMIT)

Pas përafrimit të plotë të kufijve, sipas pikës 4 të këtij neni, me kufijtë e parashikuar në legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian, për të rregulluar efektet e inflacionit, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit duhet, të paktën një herë në 5 vjet, bazuar në matjen e inflacionit, të rishikojë dhe, kur është e nevojshme, të propozojë ndryshime ligjore, në lidhje me:

- a) kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni;
- b) kufijtë që përcaktojnë fushën e zbatimit të kërkesave për

raportimin e qëndrueshmërisë për njësitë ekonomike; dhe
c) kufijtë që përcaktojnë fushën e zbatimit të kërkesave për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë për grupet e njësive ekonomike.

Neni 5 · Standardet kontabël *Ndryshim i vogël në pikën 2*

Në pikën 2, togfjalëshi "duhet të" fshihet:

AKTUAL

Njësitë ekonomike me interes publik, si dhe rregullatorët...
duhet të zbatojnë SNRF-të...

PAS NDRYSHIMIT

Njësitë ekonomike me interes publik, si dhe rregullatorët... zbatojnë SNRF-të...

Ndryshim stilistik: detyrimi nuk ndryshon, por formulimi bëhet me i drejtpërdrejtë.

KREU II – DOKUMENTET KONTABËL DHE PASQYRAT FINANCIARE

Neni 8 · Ruajtja e dokumenteve kontabël *Afati i ruajtjes zvogëlohet*

Pika 1 – ndryshim afati:

AKTUAL

Dokumentet kontabël ruhen... për 10 vjet rresht, pas mbylljes së periudhës raportuese...

PAS NDRYSHIMIT

Dokumentet kontabël ruhen... për të paktën 5 vjet rresht, pas mbylljes së periudhës raportuese...

Afati i ruajtjes ulet nga 10 vjet minimum në 5 vjet minimum. Kjo ndikon drejtpërdrejt tek obligimet administrative të njësive ekonomike.

Neni 9 · Periudha raportuese *Fshirje fjale*

Pika 3 – fjala "gjithsesi" fshihet:

AKTUAL

...mund të jetë më e shkurtër ose më e gjatë se 12 muaj, por, gjithsesi, nuk mund të jetë më e shkurtër se 3 muaj dhe më e gjatë se 15 muaj.

PAS NDRYSHIMIT

...mund të jetë më e shkurtër ose më e gjatë se 12 muaj, por nuk mund të jetë më e shkurtër se 3 muaj dhe më e gjatë se 15 muaj.

KREU III – PËRBËRËSIT E PASQYRAVE FINANCIARE

Neni 12 · Pasqyrat financiare të konsoliduara *Ndryshim terminologjik + shtesë pika 4*

Pika 2 – Ndryshim terminologjik

AKTUAL

...Grupet e vogla përjashtohen nga detyrimi për të hartuar pasqyra financiare të konsoliduara dhe raport drejtimi të konsoliduar ...

PAS NDRYSHIMIT

...Grupet e vogla përjashtohen nga detyrimi për të hartuar pasqyra financiare të konsoliduara dhe raport të konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë ...

↑ PIKA 4 E RE

"Përrjashtimet nga detyrimi për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe të raportit të konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë zbatohen për aq kohë sa nuk cënohen detyrimet e tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi vendas në lidhje me fushat më poshtë, kur:

- a) këto dokumente kërkohen për informimin e punëmarrësve ose të përfaqësuesve të tyre; ose
- b) këto dokumente kërkohen nga një autoritet administrativ ose gjyqësor për qëllimet e veta."

NEN PLOTËSISHT I RI – 6 PIKA

Ky nen përcakton rastet kur një njësi ekonomike ka detyrimin të hartojë pasqyra të konsoliduara, bazuar në kriteret e kontrollit:

- **Pika 1** – Kontrolli i drejtpërdrejtë: shumicë votash, e drejta e emërimit të shumicës së organeve, kontroll kontraktual, ose emërim i faktshëm i shumicës.
- **Pika 2** – Kontrolli faktik: ndikim dominues ose drejtim i unifikuar.
- **Pika 3** – Mbledhja e të drejtave të votës nga njësitë e kontrolluara dhe personat që veprojnë për llogari të njësisë mëmë.
- **Pika 4** – Përrjashtim: të drejtat që burojnë nga aksione të mbajtura si kolateral ose për dhënien e huave.
- **Pika 5** – Reduktimi i totalit të votave duke përrjashtuar aksionet e mbajtura nga vetë njësia e kontrolluar.

- **Pika 6** - Rregullat e hollësishme për vlerësimin dhe metodat e konsolidimit caktohen nga standardet e aplikueshme.

Neni 15 · Inventari i aktiveve dhe detyrimeve *Pika 1 – heqje reference procedurash*

AKTUAL (PIKA 1)

Njësitë ekonomike... duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

PAS NDRYSHIMIT (PIKA 1)

Njësitë ekonomike... duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta.

Pika 2 mbetet e pandryshuar.

Neni 16 · Shënimet shpjeguese *Shtesë shkronjat b, c dhe pika 5*

Pika 2 – Shtesë shkronjave b dhe c pas shkronjës a

↑ SHKRONJA B) E RE

"shumën e paradhënieve dhe kredive të dhëna anëtarëve të organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikëqyrëse, duke specifikuar normat e interesit, kushtet kryesore, si dhe të gjitha shumat e shlyera, të fshira ose të hequra dorë, si edhe angazhimet e ndërmarra në emër të tyre përmes garancive të çdo lloji, me specifikimin e totalit për secilën kategori."

↑ SHKRONJA C) E RE

"shumat që duhet të paguhen nga njësia ekonomike dhe që janë të detyrueshme për pagesë pas më shumë se pesë vitesh, si dhe të gjitha detyrimet e saj të siguruara me garanci të dhëna nga vetë njësia ekonomike, duke specifikuar natyrën dhe formën e garancisë."

Pika 3, shkronja c) – ndryshim hyrjeje

AKTUAL

Sa më sipër, nuk aplikohet nga njësia ekonomike mëmë në rastet kur...

PAS NDRYSHIMIT

Përfshimisht nga përcaktimet në shkronjat "a", "b" dhe "c", nuk aplikohet nga njësia ekonomike mëmë në rastet kur...

Pika 5 – E re

↑ PIKA 5 E RE (TË GJITHA NJËSITË)

"Të gjitha njësitë ekonomike duhet të japin informacion mbi kategoritë kryesore të të ardhurave të shfrytëzimit, të ndara sipas llojit të aktivitetit ekonomik."

Neni 17 · Raporti i ecurisë së veprimtarisë *Ngushtohet subjekti + pika 2 e re + fshirje c)*

Pika 1 – Ndryshim subjekti

AKTUAL

Njësitë ekonomike, subjekti i këtij ligji, njësitë ekonomike përgatitin raportin e ecurisë...

PAS NDRYSHIMIT

Njësité ekonomike fitimprurëse, subjekt i këtij ligji, përgatitin raportin e ecurisë...

OJF-të përjashtohen nga ky detyrim sipas formulimit të ri.

Pika 2 – E re (njësi me xhiro mbi 450 mln euro dhe 1,000 punonjës)

↑ PIKA 2 E RE

"Njësité ekonomike të cilat, në datën e raportimit, tejkalojnë vlerën prej 450,000,000 euro të të ardhurave të shfrytëzimit dhe kanë një numër mesatar prej më shumë se 1,000 punonjësish gjatë vitit financiar, raportojnë informacion mbi aktivet e tyre jomateriale dhe shpjegojnë se si modeli i biznesit varet nga këto aktive dhe si ato përbëjnë një burim krijimi vlere."

Pika 3, shkronja c) – Fshihet

AKTUAL – PIKA 3, SHKRONJA C) (PËRJASHTIM NGA RAPORTI)

c) njësité ekonomike jofitimprurëse, për të cilat shifra e aktivitetit ose e të ardhurave në pasqyrat financiare nuk tejkalon vlerën 30 milionë lekë.

PAS NDRYSHIMIT

Shkronja c) shfuqizohet. (Kombinohet me ndryshimin e subjektit në pikën 1 - OJF-të nuk e hartojnë raportin sepse subjekti është "fitimprurëse".)

Neni 18 · Raporti jofinanciar *Heqja e kushit "NIP" për pragun e punësimit*

Pika 1 – Zgjerim i fushës së zbatimit

AKTUAL

Njësité e mëdha ekonomike, të cilat janë me interes publik dhe e tejkalojnë kriterin e numrit mesatar prej 500 të punësuarish...

PAS NDRYSHIMIT

Njësitë e mëdha ekonomike, që tejkalojnë kriterin e numrit mesatar prej 500 të punësuarish...

Ky ndryshim heq kushtin "NIP" – raporti jofinanciar shtrihet tek të gjitha njësitë e mëdha me mbi 500 punonjës, jo vetëm ato me interes publik. Nga 2028, raporti jofinanciar zëvendësohet nga raportimi i qëndrueshmërisë.

NEN PLOTËSISHT I RI – 6 PIKA

Kush i nënshtrohet: njësi ekonomike me mbi 1,000 punonjës dhe mbi 450 mln euro të ardhura shfrytëzimi njëkohësisht.

Çfarë raportohet (pika 2):

- Modeli dhe strategjia e biznesit (rreziqet, mundësitë, plane për neutralitet klimatik 1.5 °C)
- Objektivat e qëndrueshmërisë, duke përfshirë ato për gazet me efekt serrë deri 2030 dhe 2050
- Roli i organeve drejtuese e mbikëqyrëse
- Politikat e qëndrueshmërisë
- Skemat nxitëse për organet
- Procesi due diligence dhe ndikimet negative
- Rreziqet kryesore dhe treguesit e performancës

Përfashtime nga raportimi (pika 3): informacion që dëmton pozicionin tregtar, sekrete tregtare, informacion i klasifikuar.

Raportimi i punëmarrësve (pika 4): drejtuesit informojnë dhe diskutojnë me përfaqësuesit e punëmarrësve.

Njësitë e kontrolluara (pika 6): përjashtohen kur grupi ka raport të konsoliduar qëndrueshmërie sipas SRQ.

Neni 18/2 · Informacioni i zinxhirit të vlerës *Nen i ri – pas nenit 18/1*

I RI

NEN PLOTËSISHT I RI – 7 PIKA

Ky nen rregullon informacionin e qëndrueshmërisë për zinxhirin e vlerës.

"Njësi e mbrojtur": njësi me jo më shumë se 1,000 punonjës që është pjesë e zinxhirit të vlerës. Ajo ka të drejtë të refuzojë të japë informacion që tejkalon Standardet Vullnetare (SVRQ).

Periudha tranzitore: tre vite nga fillimi i detyrimit - njësia mund të shpjegojë mungesën e informacionit dhe të përshkruajë planet.

Kontratat që i detyrojnë njësitë e mbrojtura të japin informacion mbi SVRQ janë të pavlefshme.

Neni 19 · Raporti i drejtimit të brendshëm *Shtesë dhe ndryshim shkronja ç)*

Pika 1, hyrja – shtesë

AKTUAL

Njësitë ekonomike me interes publik përfshijnë në raportin e ecurisë...

PAS NDRYSHIMIT

Njësitë ekonomike me interes publik, përjashtuar mikronjësitë, përfshijnë në raportin e ecurisë...

Pika 1, shkronja ç) – Ndryshim terminologjik dhe fjali të reja

AKTUAL (FRAGMENT)

...një përshkrim të politikave të ndryshme të zbatuara lidhur me organet... për aspekte të tilla, si: mosha, gjinia apo prejardhja arsimore dhe profesionale...

PAS NDRYSHIMIT

...një përshkrim të politikave të diversitetit të zbatuara lidhur me organet... për aspekte të tilla, si: mosha, gjinia apo prejardhja arsimore dhe profesionale...

Nëse nuk zbatohet një politikë e tillë, raporti duhet të përmbajë një shpjegim të arsyeve përkatëse. Njësitë ekonomike që përgatitin raport mbi qëndrueshmërinë konsiderohen se e kanë përmbushur këtë detyrim kur informacioni i kërkuar përfshihet në atë raport dhe bëhet referencë për të në raportin e drejtimit të brendshëm.

Nenet 20/1 – 20/7 · Raportimi i konsoliduar i qëndrueshmërisë

Sh. 7 NENE TË REJA

nene

të reja

pas

nenit

20

NENET 20/1–20/7 – SHTUAR PLOTËSISHT

Neni 20/1 - Raportimi i konsoliduar i qëndrueshmërisë

Njësia mëmë që tejkalon njëkohësisht 450 mln euro të ardhura neto dhe 1,000 punonjës duhet të hartojë raport të konsoliduar qëndrueshmërie. Ai përfshin modelin e biznesit të grupit, objektivat (duke përfshirë emisionet GHG deri 2030/2050), politikat, due diligence dhe treguesit e performancës.

Neni 20/2 - Përjashtimet nga raportimi i konsoliduar

Njësitet e kontrolluara përjashtohen nëse janë të përfshira në raportin e konsoliduar të njësisë mëmë sipas SRQ ose standardeve të barasvlefshme. Njësia e kontrolluar publikon emrin, selinë dhe lidhjen (URL) e raportit të konsoliduar të mëmës.

Neni 20/3 - Standardet e raportimit të qëndrueshmërisë

SRQ specifikon çfarë raportohet: informacion mjedisor (ESRS E), social (ESRS S), qeverisja (ESRS G), etika e biznesit, marrëdhëniet me furnizuesit e komunitetet.

Neni 20/4 - Verifikimi i raportit të qëndrueshmërisë

Raporti i qëndrueshmërisë dhe i konsoliduar i nënshtrohen verifikimit të pavarur. Procedurat dhe niveli i sigurisë caktohen nga ligji i auditimit.

Neni 20/5 - Detyrimi i njësive vendase (bija) për publikim

Njësitet vendase të kontrolluara nga njësi mëmë të huaja, kur kanë të ardhura mbi 450 mln euro, detyrohen të publikojnë raportin e konsoliduar të qëndrueshmërisë të mëmës. E njëjta vlen për degët me xhiro mbi 450 mln euro.

Neni 20/6 - Përgjegjësia

Organet ekzekutive, drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësive të kontrolluara kanë përgjegjësi kolektive për hartimin dhe publikimin e raportit.

Neni 20/7 - Publikimi

Raporti publikohet bashkë me opinionin e sigurisë dhe, sipas rastit, me pasqyrat financiare, brenda afateve të nenit 22 pika 1. Depozitohet në regjistrin tregtar dhe publikohet në gjuhën shqipe ose gjuhë tjetër të pranuar.

Pika 1, pas paragr. 2: shtesë - Njësi aktive në shfrytëzimin e pyjeve primare konsiderohen ato që ushtrojnë prerjen dhe shfrytëzimin e pyjeve primare sipas legjislacionit shqiptar.

Pika 2, fund: shtesë - Sqarohen termat "institucion shtetëror" (çdo autoritet kombëtar, rajonal, lokal) dhe "projekt" (aktivitete operacionale të rregulluara nga kontratë, licencë, qira, koncesion).

Pika 3 - Pragu minimal ndryshon:

AKTUAL

Nuk është nevoja të merret parasysh çdo pagesë nën vlerën 13,500,000 lekë ...

PAS NDRYSHIMIT

Nuk është nevoja të merret parasysh çdo pagesë nën vlerën 100,000 euro ...

Pika 4 - Shtesë shkronja c): Kur pagesat i atribuohen një projekti specifik, raporti tregon shumën totale për çdo lloj pagese dhe shumën totale për secilin projekt. Deklarimi bazohet në përmbajtje, jo formë, dhe pagesat nuk mund të ndahen artificiarisht.

Pika 1 – Reformulim

AKTUAL

Njësitë ekonomike, brenda 7 muajve nga data e raportimit, depozitojnë për publikim pranë autoritetit përkatës ku janë regjistruar, pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë/raportin e konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë, raportin e auditimit...

PAS NDRYSHIMIT

Njësitë ekonomike, brenda afatit të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, depozitojnë për publikim pranë autoritetit përkatës ku janë regjistruar, pasqyrat financiare vjetore, shoqëruar sipas rastit, me raportet e tjera sipas përcaktimeve në nenet 17-21 si dhe raportin e auditimit...

Pika 3 – Kushti i OJF-ve bëhet kumulativ dhe 2-vjeçar

AKTUAL

...nëse shifra e aktivit ese e të ardhurave në pasqyrat financiare tejkalon vlerën 30 milionë lekë.

PAS NDRYSHIMIT

...nëse njëkohësisht shifra e aktivit dhe shifra e të ardhurave në pasqyrat financiare, për dy vite radhazi, tejkalojnë vlerën 30 milionë lekë.

Pika 4-6 – Të reja

↑ PIKA 4 E RE

Një kategori mikronjësish mund të përjashtohen nga detyrimi për publikimin e pasqyrave financiare, sipas akt nënligjor të ministrit.

↑ PIKA 5 E RE

Kur pasqyrat publikohen në formën e tyre të plotë, duhet të jenë në përputhje me strukturën mbi të cilën audituesi ka dhënë opinionin dhe shoqërohen me raportin e auditimit.

↑ PIKA 6 E RE – VERSIONI I SHKURTUAR

Kur pasqyrat publikohen në version të shkurtuar, ai duhet të përmbajë: a) deklaratë se versioni është i shkurtuar; b) tregues për regjistrin ku janë deposituar pasqyrat e plota; c) deklaratë mbi llojin e opinionit (i pamodifikuar / me rezervë / negativ / pa

opinion); ç) deklaratë nëse raporti i auditimit ka përfshirë theksim çështjeje.

Neni 23 · Përgjegjësitë *Ndryshime terminologjike + shtesë pika 3*

Pika 1: "janë përgjegjës solidarë" → "janë bashkarisht përgjegjës"

Pika 2: "çliron" → "përrjashton"

Pika 3 - Shtesë:

↑ FJALI E RE PAS PIKËS 3

"Personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare përgatit një deklaratë përgjegjësie, e cila publikohet së bashku me pasqyrat financiare vjetore. Forma dhe përmbajtja e saj miratohen me urdhër të ministrit, me propozim të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit."

KREU III/1 – I RI: RAPORTI PËR INFORMACIONIN E TATIMIT MBI TË ARDHURAT

Nenet 23/1 – 23/4 · Raporti tatimor country-by-country *Kre i ri
i shtuar
pas
nenit
23*

4 NENE TË REJA

KREU III/1 I RI – 4 NENE

Neni 23/1 - Kush detyrohet të raportojë

- Njësi mëmë shqiptare (nivel më i lartë) me të ardhura mbi 750 mln euro konsoliduara për dy vite radhazi.

- Njësi të pavarura shqiptare me të ardhura mbi 750 mln euro për dy vite radhazi.
- Njësi vendase të kontrolluara nga mëma të huaja mbi 750 mln euro (kur mëma nuk raporton vetë).
- Degët vendase të njësive të huaja mbi 750 mln euro (kur mëma nuk ka njësi të kontrolluara vendase).
- Përjashtim: njësi që operojnë vetëm brenda një juridiksioni ose institucione financiare që raportojnë sipas legjislacionit të posaçëm.

Neni 23/2 - Çfarë përmban raporti

Raporti paraqet informacion veçmas për çdo juridiksion tatimor ku njësia operon. Për juridiksionet jobashkëpunuese: detaj i plotë. Për të tjerat: agregat. Informacioni përfshin:

- Emrin, vitin, monedhën, listën e njësive të konsoliduara
- Natyrën e veprimtarive
- Numrin e punonjësve
- Të ardhurat (sipas formulave të specifikuara)
- Fitimin/humbjen para tatimit
- Tatimin e njohur gjatë vitit
- Tatimin e paguar në mjete monetare
- Fitimet e akumuluar

Neni 23/3 - Publikimi

Raporti publikohet brenda 12 muajve nga mbyllja e vitit financiar, falas, në gjuhën shqipe ose gjuhë tjetër të pranuar, në faqen e internetit të njësisë.

Neni 23/4 - Përgjegjësia

Organet ekzekutive, drejtuese dhe mbikëqyrëse kanë përgjegjësi kolektive për hartimin, publikimin dhe aksesueshmërinë e raportit.

Neni 24 · Statusi dhe detyrat e KKK *Kufizim autoriteti + shtesë qëndrueshmëria*

Pika 2, shkronja a) – Kufizim autoriteti

AKTUAL

...ai e ka autoritetin që ta bëjë një gjë të tillë, vetëm pasi të shpjegojë dhe të justifikojë arsyet e këtij veprimi...

PAS NDRYSHIMIT

...Këshilli rekomandon ministrin përgjegjës për financat për ta bëjë një gjë të tillë, vetëm pasi të shpjegojë dhe të justifikojë arsyet e këtij veprimi...

Pika 2, shkronja e) – Shtesë qëndrueshmëria

AKTUAL

të publikojë në faqen zyrtare standardet kombëtare të kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të detyrueshme për zbatim.

PAS NDRYSHIMIT

të publikojë në faqen zyrtare standardet kombëtare të kontabilitetit dhe përkthimin në gjuhën shqipe të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe standardeve ndërkombëtare të raportimit të qëndrueshmërisë, të detyrueshme apo vullnetare për zbatim.

Pika 2, shkronja f) – Shtesë

AKTUAL

të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar ...

PAS NDRYSHIMIT

të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit raportimit financiar dhe raportimit të qëndrueshmërisë ...

Neni 25 · Përbërja dhe mandati i KKK Shtesë "lirohen"

AKTUAL – PIKA 2

Anëtarët e KKK mandatohen me urdhër të ministrit...

PAS NDRYSHIMIT

Anëtarët e KKK mandatohen dhe lirohen me urdhër të ministrit...

KREU V – DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 31 · Dispozita kalimtare Shtesë pikat 4 e 5 – hyrja në fuqi e qëndrueshmërisë

Pikat 1–3 mbeten të pandryshuara. Shtohen pikat 4 e 5:

↑ PIKA 4 E RE – HYRJA NË FUQI E RAPORTIMIT TË QËNDRUESHMËRISË

Kërkesat për raportimin e qëndrueshmërisë, raportin e konsoliduar të qëndrueshmërisë dhe raportin e tatimit mbi të ardhurat **zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat raportuese që fillojnë nga viti 2028 e në vijim.**

Njësitë e mëdha ekonomike (neni 18) hartojnë dhe publikojnë raportin jofinanciar deri me periudhën raportuese të vitit 2027, sipas kërkesave aktuale.

Nga periudha raportuese e vitit 2028 e në vijim, **raporti jofinanciar shfuqizohet dhe zëvendësohet nga raportimi i qëndrueshmërisë.**

Njësitë ekonomike mund të zbatojnë raportimin e qëndrueshmërisë mbi baza vullnetare duke filluar nga viti 2028.

↑ PIKA 5 E RE – KURSI I KËMBIMIT

Për të përcaktuar nëse tejkalohen kufijtë monetarë të shprehur në euro, njësia ekonomike i konverton treguesit me kursin zyrtar të këmbimit të datës së mbylljes së periudhës raportuese.

Neni 23 i Projektligjit · Hyrja në fuqi *Hyrja në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare*

Ky ligj hyn në fuqi pas publikimit në "Fletoren Zyrtare".

Kjo do të thotë se hyrja në fuqi nuk lidhet me një datë fikse. Megjithatë, kërkesat substantive të qëndrueshmërisë dhe të tatimit fillojnë nga viti 2028 (shih nenin 31, pika 4).